



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Didaktika e Gjuhëve të Huaja (II)

Ngarkesa: 4 kredite, 20 orë leksione: 20orë seminare.

Viti / Semetri : Viti III, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë, letërsi dhe qytetërim francez.

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore : Studentët të marrin njohuritë bazë të lëndës Didaktikë e gjuhës frënge. Të njohin marrëdhëniet në klasë dhe t'i shfrytëzojnë në funksion të mësimdhënies dhe motivimit të nxënësve. Të analizojnë dhe të formojnë një gjykim personal, të arsyeshëm dhe aktiv mbi materialet e ndryshme didaktike. Të njohin dhe të përdorin parimet bazë dhe kriteret e vlerësimit të njohurive në gjuhën frënge.

Rezultatet e pritshme:

1. Studenti të zbulojë nga përvoja e tij si nxënës kompetencat bazë të mësuesit të gjuhës frënge.
2. Të punojë në ndërtimin e një njësie didaktike për një nivel të caktuar.
3. Të dijë të seleksionojë materiale didaktike për një grupmoshë të caktuar.
4. Të zbulojë marrëdhëniet midis nxënësve dhe të jetë në gjendje të organizojë klasën.
5. Të zgjidhë konflikte të mundshme në klasë.
6. Të kombinojë mësimdhënien me edukimin e qytetar të nxënësve.